

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

-OBJEKTI I PROCEDURËS:

“KARBURANT”

MARRËVESHJE KUADËR, 12 MUAJ

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

Vlera e pritshme në total e përlogaritur e MK: 27 867 160(njëzetë e shtatë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë lekë) **Lekë pa tvsh** ose 289 860,2 (dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë presje 2) euro **Euro pa TVSH**.

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 12.03.2026 është 96.14 (nëntëdhjetë e gjashtë pikë katërmëdhjetë) Lek për 1(një) Euro.

Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit

1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor i është referohuar një ose më shumë alternativave të nenit 76 të VKM-së nr.285/2021 të ndryshuara të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.);

ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;

ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritetet e tjera kontraktore;

ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi ligjor: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi i AK-se : Vlera e sigurimit te ofertes eshte logaritur ne 2% te vleres se fondit limit siç eshte parashikuar ne ligj.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me Licencë të tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 40, pika 5, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, i cili përcakton se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu, kjo kërkesë është bazuar dhe në Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” si dhe në VKM nr.970 datë 2.12.2015, e ndryshuar, pika 1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43 pika 2/a dhe pika 3 te VKM-se nr. 285 dt. 19.05.2021 te ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të 3(tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024,2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet se:

"Nëse vlerësohet, autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit", si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.", si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri, paraqitja e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, për të gjitha pikat e ushtrimit të veprimtarisë sipas QKB.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të procedurës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, ndaj kërkohet që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e mësipërm. Përqindja e kërkuar konsiderohet e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi.

2.3.2 Të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose organet e tjera kompetente, që të provojë se ka importuar ose tregtuar karburante sipas standardeve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë, jo më parë se 6 muaj nga hapja e ofertave.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40 pika 6/c) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, VKM nr. 410, datë 13.5.2015 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, VKM nr. 147 datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, Benzinë dhe Diezel”.

Me anë të kriterëve të mësipërme kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucioni i autorizuar ISHTI (e cila është struktura përgjegjëse për inspektimin për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës) dhe që vërteton pajtueshmërinë e parametrave cilësorë të karburantit me specifikimet teknike.

2.3.3 Të paraqesë Raport Analize për Tregun e Brendshëm, për cilësinë e karburantit, lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) i cili vërteton se produktet objekt prokurimi janë në përputhje me standardet e miratuara, i lëshuar jo më parë se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në pikën 6/c, të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Raport analiza e karburantit, është një dokument i rëndësishëm, pasi dokumenton cilësinë e karburantit të tregtuar nga OE. Kjo garanci, lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të karburanteve të tregtuara. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë, i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për ofrimin e karburantit cilësor. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj duke përfshirur edhe specifikimet teknike, është kërkuar që të paraqitet raport analizimi për cilësinë e karburantit. Raporti i analizës konsiston në cilësinë, koston dhe ndikimit mjedisor të karburantit, cilësia e dobët sjell konsum të tepërt të karburantit, ndotje të mjedisit dhe konsumim të motorrit të mjeteve.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë të pakten 2 (dy) stacione shpërndarje të karburantit brenda territorit të Bashkisë Vlore. Kjo të provohet me dokument pronësie, ose me kontrate qeraje të nënshkruar të noterit.

Nuk do të pranohet furnizimi i karburanteve nga operatore ekonomike që nuk disponojnë pika furnizimi karburant në qytetin e Vlores dhe operojnë me marreveshje bashkëpunimi.

Për stacionet e tregtimit të karburanteve duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë

- Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK)
- Certificate e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, pikat 3, 5/a nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM-së Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, të ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri nga AK është bërë duke marrë parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale.

Per sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

Dokumentacioni për stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve është kërkuar sipas parashikimit të pikës II “Procedura për dhënien e licencave për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë” të VKM-së Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, i ndryshuar, me anë të së cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licensat profesionale si dhe dokumentacionin shoqëruar, për furnizimin e mallrave, objekt kontrate, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në kushtet kur kemi të bëjmë me furnizim me kartë elektronike.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratat si më poshtë:

- Të deklarojë, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepermjet kartave elektronike të personalizuar, për automjetet e Autoritetit Kontraktor.

- Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem“, Operoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (ëeb page), ku furnizimi i karburantit per mjetet e transportit te kryhet nepemjet kartës elektronike. Administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet Autoriteti kontraktor

Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara me siper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (ëebpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarres perben kusht per s’kualifikim

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme jane përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar , nenit 40, pika , gërma 5/ç dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar si dhe bazuar ne VKM-ne nr.561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshem”, me ane te se cilit operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci per AK se furnizimi do te realizohet me karta elektronike sipas kerkesave te parashikuara me lart.

2.3.6 Operatori ekonomik ofrues duhet të jetë i pajisur me **Certifikatën ISO 14001: 2015**, ose ekuivalente, lidhur me sistemet e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin prokurimit si dhe të jetë e vlefshme, akredituar nga DPA ose nga organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Standarti 14001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” – është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që ky Standarti është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, dhe në rastin konkret ku objekt prokurimi është furnizimi me karburant, proces I cili mund të jetë të dëmshme për mjedisin. Paisja me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që ofertuesi do të zbatojë politika të qëndrueshme mjedisore, duke zvogëluar ndotjen dhe ndikimin e dëmshëm në mjedis.

Specifikimet teknike

Për zërin Gazoil (10ppm):

Intervalet lidhur me treguesin e densitetit për produktin bëhen sipas standarteve:

Për gazoil-sipas standardit shqiptar S SH EN 590:2025 ose standardeve të tjera ekuivalente.

SPECIFIKIME TEKNIKE				
Nr.	Treguesit	Njësia e matjes	Kufijtë e lejuar	
			Min.	Max.
1	Numri i Cetanit		51	
2	Indeksi i Cetanit		46	
3	Densiteti ne 15°C	Kg/m ³	820	845
4	Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10
5	Pika e flakërimit	°C	55	-
6	Mbetja e karbonit (10% mbetje distilimi)	% m/m	-	0.3
7	Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200
8	Viskoziteti në 40°C	mm ² /s	2,000	4,500

Për zërin benzinë:

Intervalet lidhur me treguesin e densitetit për produktin bëhen sipas standarteve:

Për benzinën -sipas standardit shqiptar S SH EN 228:2025 ose standardeve të tjera ekuivalente.

SPECIFIKIME TEKNIKE				
Nr.	Treguesit	Njësia e matjes	Kufijtë e lejuar	
			Min.	Max.
1	Numri Oktanit Kërkimi, RON		95	-
2	N Numër Oktani Makine, MON		85	-
3	Densiteti ne 15 °C	Kg/m ³	720	775
4	Përmbajtja e plumbit	mg/l		5
5	Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10
6	Përmbajtja e magnezi	mg/l	-	2
7	Rrip korozioni bakri 3 h në 50°C	vlerësim	Klasi 1	

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Argumentimi: Specifikimet teknike të vendosura nga AK, nuk përmbajnë elemente marke /brandi dhe janë hartuar sipas standartit S SH EN 590:2025 ose ekuivalent për artikullin Gazoil (10 ppm) dhe në përputhje me S SH EN 228:2025 ose ekuivalent për artikullin Benzine.

AK i është referuar kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date, në përlogaritjen e cmimit për njësi në bazë të formulës së aplikuar bazuar në :

VKM-ne Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku evidentohet që ofertuesit do të përlogaritin Çmimin Njësi mbështetur në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, pjesë e DST sipas shtojcës 6.

NJESIA E PROKURIMIT